VENDIM
Nr.194, datë 12.11.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVIZIONIN PRIVAT VENDOR "TV REAL"
SUBJEKTIT: "RTV-REAL" SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", si dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.98, datë 24.9.2010 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë televizivë analogë vendorë", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "Rtv-Real" sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vlorës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati